

Përkufizimi:

Gjuhësisht, fjala teuessul (teuessul) nënkupton afrimi, e cila në thelb nënkupton diçka nëpërmjet së cilës

arrijmë ose afrohemi te një gjë.

Fjala teuessul në terminologjinë fetare nënkupton marrjen e shkaqeve të lejuara, që na afrojnë te Allahu Fuqiptotë.

Llojet e teuessulit:

1. Teuessul i ligjësuar () .????? ?????

2. Teuessul i ndaluar () .????? ?????

Teuessuli i ligjësuar:

Teuessuli i ligjësuar është tri llojesh:

1. Teuessuli (afrimi te Allahu) nëpërmjet emrave dhe cilësive të Allahut.
2. Teuessuli që e bën lutësi nëpërmjet ndonjë vepre të mirë që e ka bërë.
3. Teuessuli, afrimi i robit te Allahu nëpërmjet duasë së ndonjë njeriu të mirë, i cili është i gjallë.

Teuessuli i ndaluar:

Çdo teuessul që nuk bën pjesë në ndonjërin nga tri llojet e teuessulit të ligjësuar, të cilat i përmendëm më lart, është i ndaluar. Këtu bëjnë pjesë:

1. Afrimi te Allahu nëpërmjet hakut dhe privilegjit të ndonjë personi.
2. Zotimi që bëhet për të dashurit e Allahut, njerëzit e mirë dhe dua që u drejtohet atyre.
3. Therja e kurbanit për hir të të dashurve të Allahut dhe adhurimi që bëhet te varret e tyre.

“Et-Teuhijd el-mujesser” i autorit Abdullah El-Huvejl

Përktheu: Jusuf Kastrati – Shembulli.com